



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Departamenti i Industrisë - Divizioni për Politika Industriale

SEKTORI C

INDUSTRIA PËRPUNUESE

R
A
P
O
R
T

2
0
2
4



Përmbajtja

Lista e shkurtesave	4
Lista e tabelave.....	5
Lista e figurave.....	6
Hyrje.....	7
Metodologjia.....	8
ANALIZA EKONOMIKE	9
Bruto produkti vendor	9
Pjesëmarrja e vlerës së shtuar në BPV.....	10
Vlera e shtuar për kokë banori.....	11
Pjesëmarrja e vlerës së shtuar në BPV sipas sektorëve	11
Investimet e huaja direkte	12
Investimet e huaja direkte sipas aktivitetit ekonomik.....	13
Investimet e huaja direkte sipas shteteve	14
Tregu financiar.....	15
Kreditë e brendshme nga bankat për sektorin privat (% e BPV-së)	15
Bilanci tregtar	15
Pjesëmarrja e eksporteve në (% e BPV)	16
Eksportet dhe importet.....	16
 ANALIZA SOCIALE	 37
Fuqia punëtore	37
Pjesëmarrja e sektorit C në punësim.	37
Kontributi i nën sektorëve në punësimin e përgjithshëm të Sektorit-C.....	39
Gratë të punësuar në sektorin C	40
Elasticiteti i punësimit	41
Pagat në prodhim	42
Intensiteti relativ i pagave në industrializim	43
Totali i pagave në sektorin-C	43
 ANALIZA MJEDISORE	 44
Eficienca e energjisë në sektorin e prodhimit	44
Intensiteti i energjisë në prodhim.....	44
Emetimet e CO2	45
Intensiteti i CO2 për vlerën e shtuar në Prodhim.....	46

Industria e gjelbër dhe qarkore.....	46
Mbeturinat e trajtuara (ricikluara) sipas viteve dhe llojit.....	46
Përmbledhje e indikatorëve.....	48
Konkluzionet.....	49
Referencat.....	50

Lista e shkurtesave

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	-	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	-	Bashkimi Evropian
BKK	-	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
BPV	-	Bruto Prodhimi Vendor
BQK	-	Banka Qendrore e Kosovës
DI	-	Departamenti i Industrisë
DK	-	Dogana e Kosovës
DPI	-	Divizioni për Zhvillimin e Politikave Industriale
IHD	-	Investimet e Huaja Direkte
KTD	-	Korporata Tjera Depozituese
MINT	-	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
NMVID	-	Norma Mesatare Vjetore e Interesit në Depozita
VSHP	-	Vlera e Shtuar e Prodhimit
WITS	-	Sistem i Integruar i Tregtisë Botërore
WDI	-	Treguesit e Zhvillimit Botëror
KTOE	-	Kilo ton për njësi ekuivalente të naftës

Lista e tabelave

Tabela 1	IHD sipas sektorëve ekonomike, 2016 – 2023.....	13
Tabela 2	IHD sipas vendeve të origjinës, 2015 – 2023.....	14
Tabela 3	Normat efektive të interesit në kredi të KTD-ve.....	15
Tabela 4	Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e CEFTA-së, EFTA-së, BE-së dhe Vendet tjera 2023– 2024.....	19
Tabela 5	Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e BE-së 2023– 2024	25
Tabela 6	Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e CEFTA-së 2023 – 2024	25
Tabela 7	Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e EFTA-së 2023 – 2024.....	29
Tabela 8	Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e tjera për vitin 2023 -2024.....	33
Tabela 9	Sektori C, numri i ndërmarrjeve, të punësuarve dhe qarkullimi, 2022-2024	38
Tabela 10	Elasticiteti i punësimit krahasuar me vendet tjera për vitet 2015-2023	41
Tabela 11	Pagat për vitin 2022	42
Tabela 12	Paga mesatare sipas aktiviteteve ekonomike në Kosovë, 2023-2024, (Euro).....	43

Lista e figurave

Figura 1	Performanca e BPV-së/ kokë banori e Kosovës krahasuar me vendet e rajonit.....	9
Figura 2	Vlera e shtuar e sektorit prodhues pjesëmarrja në BPV.....	10
Figura 3	Vlera e Shtuar e Prodhimit për kokë banori në VSHP, Kosova krahasuar me vendet tjera...	11
Figura 4	Vlera e shtuar në BPV sipas sektorëve.....	12
Figura 5	Bilanci tregtar i Kosovës.....	15
Figura 6	Pjesëmarrja e eksporteve totale në (% e BPV).....	16
Figura 7	Kontributi i nën sektorëve në punësimin e Sektorit-C, në %.....	39
Figura 8	Punësimi gjithëpërfshirës në % (sipas gjinisë).....	40
Figura 9	Intensiteti relativ i pagave të industrisë.....	43
Figura 10	Efiçienca e energjisë në sektorin e prodhimit.....	44
Figura 11	Intensiteti i energjisë.....	45
Figura 12	Emetimet e CO2, për 1 milion euro në VSHP.....	45
Figura 13	Intensiteti i CO2 për 1 milion euro në VSHP të gjeneruar.....	46
Figura 14	Mbeturinat e trajtuara (recikluara sipas llojit).....	46

Hyrje

Zhvillimi industrial në Kosovë ka qenë një proces kompleks dhe shpesh sfidues, si pasojë e ndryshimeve politike, ekonomike dhe sociale që ka kaluar periudhën e luftës. Transformimi i sektorit synon krijimin e një ekonomie me të ardhura më të larta, për krijimin e një standardi dhe mirëqenie më të mirë.

Transformimi gradual i industrisë në Kosovë ka për qëllim kalimin drejt një ekonomie me të ardhura më të larta, për përmirësimin e mirëqenies socio-ekonomike të qytetarëve të Kosovës. Ky proces në vazhdimësi kërkon investim në kapacitete prodhuese për të krijuar një ambient më të favorshëm për investime në industri.

Ndoshta më shumë se sektorët e tjerë, prodhimi ka një potencial më të lartë për të krijuar produktivitet të konsiderueshëm dhe fitime shtesë në vlerë, duke tërhequr teknologjitë e reja dhe inovacion. Për më tepër, zhvillimi industrial ka implikime të tjera pozitive për sektorët e prodhimit, për shkak të lidhjeve të ndryshme me sektorët e tjerë të ekonomisë. Zhvillimi industrial mund të stimulojë rritjen dhe zhvillimin në sektorë të tillë si bujqësia dhe minierat në Kosovë dhe në industritë e shërbimeve përkatëse.

Për të pasur një pasqyrë të detajuar mbi gjendjen dhe trendet e zhvillimit të industrisë, hartuesit e politikës industriale në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, bazuar në të dhënat statistikore të përpunuara, kanë përgatitur raportin vjetor të industrisë përpunuese 2024, për analizën e performancës të sektorit-C, duke analizuar tre dimensionet kryesore: dimensionin ekonomik, social dhe mjedisor.

Qëllimi i hartimit të Raportit Vjetor është paraqitja e trendëve kryesore të zhvillimit të ekonomisë së Kosovës, me theks të veçantë në degët kryesore industriale, gjatë vitit 2024, por edhe një analizë krahasuese me vendet e rajonit, si dhe trendi i zhvillimeve në sektorët e industrisë përpunuese.

Të dhënat e analizuara, që janë paraqitur në këtë raport, mund t'iu shërbejë institucioneve, akademikëve, hartuesve të politikave, bizneseve operuese, (të tanishme dhe atyre me potencial në sektorin privat), investitorëve, donatorëve, hulumtuesve, etj. Raporti për Sektorin-C (industrinë përpunuese) ofron një pasqyrë më të hollësishme rreth trendëve kryesore me ndikim në industrinë e vendit si dhe lehtëson punën e të gjithë akterëve përkatës në hartimin e politikave zhvillimore më të efektshme, bazuar në indikatorë të matshëm.

Metodologjia

Raporti është hartuar duke përdorur metodat e studimeve të raporteve të ndryshme hulumtuese si dhe të dhënave sasiore dhe cilësore të pranuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës, treguesit e Bankës Botërore dhe institucionet tjera relevante.

Të dhënat sasiore dhe cilësore, janë përpunuar dhe analizuar nga stafi i MINT-it konkretisht nga përpunuesit e të dhënave statistikore dhe hartuesit e politikave industriale në Departamentin e Industrisë.

Me qëllim të ofrimit të informatave të sakta të paraqitura në format tabelore dhe figurative janë përdorur metodat e kombinimit dhe krahasimit për të dhënat e prezantuara.

Të dhënat statistikore janë përpunuar në pjesën e përgjithshme për Industrinë përpunuese të Sektorit-C, vlerat e përgjithshme që përfshinë kodet e nënsektorëve 10-33, duke krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor (BP6). Përshkrimi i nën sektorëve, në këtë Raport është radhitur sipas kodeve, ashtu siç janë të radhitura në NACE Rev.2.

Të dhënat për nën sektorët për eksportin dhe importin, për nën aktivitetet, ndërmarrjet, punësimin dhe qarkullimin në Kosovë janë paraqitur sipas kodit katër shifror NACE Rev.2.

Nga të dhënat statistikore të përpunuara janë hartuar analiza që mbulojnë tre dimensionet: ekonomik, social dhe mjedisor. Këto dimensionet trajtohen në mënyrë të integruar për të pasqyruar gjendjen e industrisë përpunuese/prodhuese në Kosovë.

Pas analizave janë paraqitur konkluzionet që kanë të bëjnë me gjendjen dhe trendët e prodhimit në industrinë përpunuese/prodhuese (Sektori C) në Kosovë.

Për të gjitha të dhënat që janë përdorur në Raportin Vjetor për industrinë përpunuese/prodhuese janë shënuar thirrjet apo burimi i informatave.

ANALIZA EKONOMIKE

Bruto produkti vendor

Bruto Produkti Vendor (BPV) është treguesi më i rëndësishëm ekonomik i llogarive kombëtare, i cili paraqet performancë ekonomike të një shteti në një periudhë të caktuar kohore.


Sipas raportit vjetor të BQK-së, Ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje të qëndrueshme prej 4.4 % të BPV-së në vitin 2024, mbështetur nga konsumi, investimet dhe eksportet, ndërsa importet vazhduan të jenë të larta duke ndikuar si komponentë negativisht në kalkulimin e BPV-së.

Sipas të dhënave të “Eurostatit” dhe Statistikave Kombëtare të Kosovës, në vitin 2024, Bruto Produkti Vendor (BPV) për kokë banori në Kosovë ishte 6,747.40 euro, që do të thotë se është nën mesataren e BP6, sa është 10,159.20 euro.

Edhe pse është filluar nga një bazë e një niveli të ulët, Kosova ka një ritëm rritjeje më të shpejtë krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Nga 2021 deri në 2024, GDP-ja për kokë banori në Kosovë ka pasur një rritje të ndjeshme, duke u rritur nga 4,455.50 euro në 6,747.40 euro.

Gjatë periudhës ndër vite, rritjet vjetore kanë qenë, përkatësisht 12.9% në vitin 2022, 14.3% në vitin 2023 dhe 17.3% në vitin 2024. Megjithatë, në vitin 2024 në realizimin e regjistrimit të popullsisë u evidentua një ulje e numrit të banorëve të Kosovës.

Figura 1: Performanca e BPV-së/ kokë banori e Kosovës krahasuar me vendet e rajonit



Burimi: Eurostat, përpunuar nga MINT/DI/DPI

Pjesëmarrja e vlerës së shtuar e prodhimit në BPV


Sistemi i Llogarive Kombëtare të Kombeve të Bashkuara kërkon që vlera e shtuar të vlerësohet me çmimet bazë (duke përjashtuar taksat neto mbi produktet), ose me çmimet e produkteve të prodhuara (përfshirë taksat neto mbi produktet e paguara nga prodhuesit, por duke përjashtuar shitjet ose taksat mbi vlerën e shtuar). Të dyja këto vlerësime përjashtojnë tarifën e transportit që faturohen veçmas nga prodhuesit. Bruto Produkti Vendor (BPV) total matet me çmimet e blerësve, ndërsa vlerat e shtuar nga industria zakonisht matet me çmimet bazë.

Në 2024, industrializimi i Kosovës, i matur sipas pjesëmarrjes së vlerës së shtuar të prodhimit në Bruto Produkt Vendor (BPV), arriti në 13.1%, një përqindje më të lartë se mesatarja e vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP6), e cila është 10.1%. Kjo tregon një performancë më të mirë të industrisë kosovare në krahasim me mesataren e BP6.

Në krahasim me disa vende të tjera të rajonit, Kosova ka vlerë më të lartë të prodhimit (% BPV). Për shembull, Mali i Zi është vetëm 3.18%, Shqipëria 6.17%, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina arrin në 11.6%. Këto shifra tregojnë se industrializimi në Kosovë është më i avancuar në krahasim me këto vende.

Ky trend pozitiv mund të shërbejë si një sinjal i tillë për investitorët e huaj dhe lokalë që të mbështesin më shumë sektorë industrialë, duke forcuar edhe më shumë ekonominë vendore.

Figura 2. Vlera e shtuar e sektorit prodhues në BPV¹



Burimi: World Development Indicators

¹ Të dhënat për vitin 2024 për Serbinë dhe Malin e Zi nuk janë publikuar, andaj janë marrë të dhënat nga viti 2023.


Vlera e Shtuar për kokë banori

Vlera e shtuar për kokë banori tregon bazën e nivelit të industrializimit të një vendi të përshtatur për madhësinë e ekonomisë. Një nga përdorimet statistikore të VShP për kokë banori, është klasifikimi i grupeve të vendeve sipas fazës së zhvillimit industrial.

Kapaciteti prodhues i një vendi matet përmes vlerës së shtuar që gjenerohet në sektorin e prodhimit, e ndarë për kokë banori. Kjo shifër pasqyron sa vlerë ekonomike krijohet nga aktivitetet prodhuese për çdo individ në vend që është fuqia e zhvillimit ekonomik.

Në vitin 2024, Kosova arriti një vlerë të shtuar në sektorin e prodhimit prej 851 euro për kokë banori, një rezultat që vendos atë mbi mesataren e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP6), ku kjo vlerë mesatare është 733 euro për kokë banori. Megjithatë, krahasuar me Serbinë, Kosova mbetet pas, pasi Serbia ka një vlerë të shtuar në sektorin e prodhimit për kokë banori prej 1,319.00 euro.

Figura 3: Vlera e Shtuar e prodhimit për kokë banori, Kosova krahasuar me vendet tjera



Burimi: WDI, (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)²


Pjesëmarrja e vlerës së shtuar në BPV sipas sektorëve

Ndërmjet viteve 2011 dhe 2024, Kosova ka pak ndryshime në strukturën e saj ekonomike. Rëndësia e sektorit të prodhimit për ekonominë e përgjithshme ka mbetur e kufizuar. Kontributi i vlerës së shtuar në prodhim (VShP) në bruto produktin vendor (BPV) ka qenë i qëndrueshëm, me ndryshime të vogla ndërmjet viteve 2023 dhe 2024.

² Të dhënat për vitin 2024 për Serbinë dhe Malin e Zi nuk janë publikuar, andaj janë marrë të dhënat nga viti 2023.

Sektori i shërbimeve ka pasur një peshë dominuese, në ruajtjen ndër vite të mesatares me rreth 45% të BPV-së. Ndërkohë, sektori i minierave dhe ndërtimtarisë ka mesatarisht 14% të BPV-së, megjithatë ka një rënie të lehtë në dy vitet e fundit, duke zbritur në rreth 13%.

Figura 4. Vlera e shtuar në BPV sipas sektorëve



Burimi: WDI, përpunuar nga stafi i DI/DPI

Investimet e huaja direkte

Investimet e huaja direkte ndikojnë në rritjen e mundësive për integrim ekonomik duke krijuar lidhje të qëndrueshme dhe afatgjata në tregjet ndërkombëtare.

Kompanitë e mëdha botërore transferojnë kapitalin e tyre në ato vende që ofrojnë kushte më të mira në investime. Përveç taksave më të ulëta, fuqisë punëtore më të lirë dhe të kualifikuar, kompanitë janë të interesuara edhe për sundimin e rendit dhe ligjit në vendin e investimeve, por edhe për sigurimin e investimeve nga vendi përfitues.

Pjesëmarrja IHD-ve të prodhimit në totalin e IHD-ve për vitin 2024 ishte 3.78%.

Investimet e huaja direkte sipas aktivitetit ekonomik

Të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës tregojnë se në vitin 2024, hyrjet neto të IHD-ve në sektorin e prodhimit ishin 32.0 milion euro, deri sa në vitin 2023, ishin 17.2 milion euro.

Sektori i patundshmërisë vazhdon të dominoj, me 76.5 % të gjithsej IHD-ve, duke shënuar rritje prej 25.4 % dhe arrin vlerën prej 648.6 milion euro, e ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të pasurive të paluajtshme dhe kërkesës së lartë për patundshmëri.

Tabela 1. IHD sipas sektorëve ekonomike, 2016 – 2024 (në milionë euro)

Sektorët	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Bujqësia, pylltari dhe peshkatari	1.3	(1.3)	0.1	1.5	2.8	1.1	0.7	0.7	0.4
Xehetaria dhe guroret	(19.1)	(4.9)	(2.7)	(6.9)	29.1	1.4	18.6	22.9	-2.3
Prodhimi	4.2	6.1	(17.7)	14.2	(4.6)	-0.4	8.9	17.2	32.0
Furnizimi me energji, gaz, avull dhe me ajër të kondicionuar	(0.4)	(0.8)	12.1	13.5	30	(38.8)	29.5	58.5	-2.7
Furnizimi me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash	0.6	0.0	2.5	(0.6)	0.2	(0.5)	(0.2)	0.2	0.0
Ndërtimi	28.1	5.1	24.8	(17.1)	11.4	16.7	26.5	11.8	6.2
Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	14.0	9.0	19.6	(6.7)	(8.1)	(4.0)	17.6	16.6	0.7
Transport dhe ruajtje	0.9	(0.8)	(0.2)	(6.2)	(16.0)	4.3	(4.1)	-12.0	-4.6
Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	0.8	1.1	1.8	1.4	1.1	0.7	(4.1)	0.2	0.5
Informacioni dhe Komunikimi	(4.2)	(3.8)	(9.6)	2.3	1.6	17.3	14.0	12.9	10.0
Aktivitete financiare dhe të sigurimit	19.0	55.2	15.5	13.9	85.1	24.6	51.9	176.6	143.4
Aktivitete të patundshmërive	139.7	154.7	205.2	223.8	201.1	384.0	529.5	517.1	648.6
Aktivitete profesionale shkencore dhe teknike	5.8	5.7	5.2	3.4	3.6	5.7	10.9	7.4	5.9
Aktivitete administrative dhe mbështetëse	21.9	23.7	4.7	3.7	0.8	1.4	10.7	-1.0	-0.5
Administratë publike dhe mbrojtje; siguri social i detyrueshëm	1.9	1.3	0.9	1.7	1.1	1.1	1.5	1.5	0.7
Arsim	0.8	0.7	0.7	1.3	1.3	1.8	2.2	1.8	0.0
Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	1.3	(1.0)	(0.4)	0.6	0.3	2.7	1.2	0.7	2.5
Art, zbavitje dhe rekreacion	0.1	0.0	0.5	0.5	(0.1)	0.1	0.6	0.6	0.0
Aktivitete të shërbimeve tjera	3.9	3.7	7.2	2.8	1.7	(1.2)	1.1	-1.1	1.6
Të pa klasifikuar	(0.3)	1.5	2.0	7.6	3.0	2.6	14.9	3.8	4.9

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës / <https://bqk-kos.org/statistikat/serite-kohore/> qasur më 18.09.2025

Nga të dhënat e tabelës nr.1, IHD-të, sipas aktivitetit ekonomik, sektori financiar dhe i sigurimit ka 143.4 milion euro investime, me rënie prej 33.2 milion euro, krahasuar me vitin 2023.

IHD-të në sektorin e prodhimit gjatë vitit 2024 janë 32.0 milion euro, me rritje prej 14.8 milion euro krahasuar me vitin 2023. Sektori i Furnizimit me energji, gaz, avull dhe me ajër të kondicionuar ka shënuar rënie të theksuar në vitin 2024 në vlerë prej -2.7 milion euro, përderisa gjatë vitit 2023 kishte 58.5 milion euro investime. Sektori Xehetaria dhe guroret ka shënuar rënie në vitin 2024 në vlerë prej -2.3 milion euro investim, krahasuar me vitin 2023 që kishte 22.9 milion euro.

Shikuar nga vlera investuese, sektori i cili ka shënuar vlerën më të lartë investive është sektori “Aktivitete të patundshmërive” me 648.6 milion euro.

Investimet e huaja direkte sipas shteteve

Sipas raportit vjetor të BQK-së për vitin 2024, llogaritë financiare të IHD-ve arritën në 847.4 milionë euro (8.2 % e BPV-së) dhe shënuan rritje të ngadalësuar prej 0.9 %, krahasuar me rritjen prej 14.8 % në vitin 2023.

Tabela 2. IHD sipas vendeve të origjinës, 2015 – 2024 (në milion euro)

Shtetet		Vitet									
		2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
AT	Austria	33.5	9.9	20.3	11.2	11.9	27.6	22.9	44.7	63.6	72.1
DE	Gjermania	45.3	25.7	55.9	60.3	70.2	67.5	121.9	194.4	196.0	201.3
SI	Sllovenia	5.6	-4.5	1.2	-8.7	6.1	8.1	5.8	20.0	34.3	25.9
GB	Britania e Madhe	26.6	13.6	27.0	57.4	0.8	21.4	0.1	-25.0	49.2	21.5
CH	Zvicra	72.9	61.8	50.6	71.0	61.9	64.1	99.2	155.7	172.6	188.3
TR	Turqia	55.4	42.7	29.5	12.2	-31.9	14.6	-38	30.2	63.4	19.4
NL	Holanda	-36.4	-23.1	-14.1	-39.7	1.9	0.1	7.6	61.6	14.7	9.9
AL	Shqipëria	40.1	28.6	2.4	22.3	15.2	39.8	50.4	47.3	64.5	88.2
LU	Luksemburgu	0.1	0.6	2.1	1.9	1.3	-2.7	-3.6	1.8	1.3	1.3
RS	Serbia	0.8	-0.6	-1.4	0.4	0.4	6.0	5.0	-0.7	1.5	-2.7
US	Shtetet e Bashkuara	25.0	23.0	20.3	35.5	22.8	29.6	63.7	97.8	66.7	87.7
FR	Franca	3.2	2.8	3.6	5.6	3.4	3.7	10.2	9.9	11.0	2.8
BG	Bullgaria	1.6	0.4	0.5	2.1	1.0	0.9	-0.8	1.4	0.6	0.8
MK	Maqedonia	0.1	3.2	-1.0	1.3	2.0	1.8	1.8	3.0	5.1	16.0
BA	Bosnja dhe Hercegovina	0.8	1.2	0.7	0.4	0.1	0.1	0.4	0.3	0.7	-0.1
HR	Kroacia	0.1	-1.7	0.7	-1.0	0.9	-1.2	3.0	1.5	9.4	1.5
MT	Malta	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.8	1.7	3.2
CY	Qipro	0.1	0.4	0.8	1.3	2.9	0.9	0.9	1.7	2.1	0.0
SK	Sllovakia	0.1	0.8	0.1	0.5	1.4	0.3	0.3	0.2	0.1	0.4
CA	Kanadaja	1.1	2.5	3.0	3.2	5.3	4.7	8.8	17.8	13.3	13.3
CZ	Çekia	1.3	0.2	0.7	1.5	0.4	0.5	1.0	0.7	2.0	1.5
AE	Emiratet e Bashkuara Arabe	1.4	3.6	13.4	-2.5	3.8	2.8	0.6	4.2	-0.9	6.2
NO	Norvegjia	2.9	3.4	3.5	5.1	4.9	3.2	7.7	7.0	6.3	7.2
KW	Kuvajti	0.0	0.2	0.0	-1.1	0.7	0.1	-0.5	-0.1	0.4	0.1
ES	Spanja	-0.8	0.2	2.5	0.3	0.7	0.0	0.3	0.1	0.9	0.3
EG	Egjipti	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
IT	Italia	5.7	1.9	7.0	2.7	7.9	3.5	8.5	10.4	12.0	19.4
GR	Greqia	-0.2	-0.4	-1.2	-0.3	0.1	-0.1	-1.1	-0.1	-0.3	0.2
HU	Hungaria	0.3	0.6	0.4	0.1	19.1	26.1	3.6	8.2	11.3	5.0
Tjera	Tjera	22.1	22.8	26.9	29.1	39.6	22.3	40.7	37.0	36.5	56.8
Gjithsej		308.8	220.0	255.4	272.1	254.8	345.7	420.4	732.0	840.1	847.4

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, [https://bqk-kos.org/statistikat/serite-kohore/qasur më 18.09.2025](https://bqk-kos.org/statistikat/serite-kohore/qasur-më-18.09.2025)

Tri shtetet kryesore me vlerat më të larta të IHD-ve janë Gjermania me 23.7%, Zvicra me 22.2% dhe SHBA-të me 10.4%. Në anën tjetër, investimet direkte të rezidentëve nga Kosova jashtë vendit shënuan rritje të dukshme, duke arritur në 224.3 milionë euro, rritje vjetore prej 18.1%. Këto investime ishin kryesisht të orientuara në sektorin e patundshmërisë në vendet e rajonit, duke reflektuar diversifikim të kapitalit dhe kërkesën në rritje për investime jashtë Kosovës.

Tregu financiar

Sa i përket normave efektive të interesit të korporatat tjera depozituese (KTD), marrë mesataren e normave të interesit për sektorët e pasqyruar në tabelën nr. 3, në vitin 2024, vërehet rënie e normës së interesit në Industri për 0.4% krahasuar me vitin 2023.

Norma efektive e interesit në sektorin e industrisë është 6.4%.

Tabela 3. Normat efektive të interesit në kredi të KTD-ve

Sektorët	Norma e Interesit 2020	Norma e Interesit 2021	Norma e Interesit 2022	Norma e Interesit 2023	Norma e Interesit 2024
Kredi Konsumuese	6.8%	6.4%	6.3%	6.4%	6.1%
Kredi Hipotekare	5.7%	5%	4.9%	5.3%	5%
Bujqësore	9.3%	7.96%	8%	9.1%	8.7%
Industriale	6.0%	5.9%	6%	6.8%	6.4%
Shërbyese	6.0%	5.9%	6%	6.6%	6.2%
Sektorët Tjerë	6.3%	6.3%	6.5%	6.9%	6.8%


Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, <https://bqk-kos.org/statistikat/serite-kohore/>

Sipas të dhënave nga tabela 3. në të gjithë sektorët vërehet rënie e normave efektive të interesit në krahasim me vitet e kaluara.

Bilanci tregtar

Bilanci tregtar paraqet raportin ndërmjet eksportit dhe importit për periudhën një vjeçare. Kosova, në vitin 2024, shprehur në vlera financiare, eksportoi 941.5 milionë euro, ndërsa importoi 6.4 miliardë euro. Raporti mes eksportit dhe importit është 1/6 ose 85.2% në favor të importit, ndërsa mbulueshmëria e importit me eksport për vitin 2024 është 14.8%.

Figura 5: Bilanci tregtar i Kosovës në (miliard Euro)




Burimi: ASK-Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ), 2024 (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Pjesëmarrja e eksporteve totale në (% e BPV)

Bazuar në të dhënat e paraqitura në figurën nr.6 pjesëmarrjen më të lartë të eksporteve në BPV ne vitin 2024 krahasuar me BP6 e ka shënuar Maqedonia e Veriut me 35%, ndërsa me pjesëmarrje më të ulët është Mali Zi me 4% dhe Kosova 9%.

Figura 6: Pjesëmarrja e eksporteve totale në (% e BPV), 2016-2024



Burimi: WDI, UNIDO, ASK (përpunuar nga DI/DPI-së)

Kosova ndër vite ka një rritje solide të pjesëmarrjes së eksportit në BPV dhe ka shënuar rritje nga 4% sa ishte në vitin 2020 në 9%, në vitin 2024, ndërsa të gjitha vendet tjera të BP6 kanë shënuar rënie të ulët në vitin 2024; Maqedonia e Veriut 35%, Bosnja e Hercegovina 20% dhe Serbia me 24%. Shqipëria dhe Mali Zi nuk ka pasur ndryshim, krahasuar me vitin 2023.

2. Eksporti dhe importi me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera, për Sektorin – C (Industria përpunuese/prodhuese)

Treguesi i numrit të ndërmarrjeve eksportuese, sipas nën sektorëve të industrisë përpunuese, tregon pjesëmarrjen e ndërmarrjeve në eksport.

Nga gjithsej 6,767 ndërmarrje në vitin 2024 në kuadër të Sektorit-C, 2,644 janë ndërmarrje eksportuese të cilat kanë eksportuar produktet e tyre me vlerë mbi 10,000 euro.

Sektor-C, në eksportin e përgjithshëm merr pjesë me 78.5%

- **Eksportet, Sektori – C**

Vlera e përgjithshme e eksporteve, për vitin 2024, në vendet e BE-së , CEFTA-së , EFTA-së dhe vendet tjera, ishte 941.50 milion euro, ndërsa sektori i industrisë përpunuese ka marrë pjesë me vlerë prej 739.46 milion euro, apo rreth 78.5%, në kuadër të eksportit të përgjithshëm.

Të dhënat në tabelën nr. 8, tregojnë se rritja e eksporteve të Sektorit-C, për vitin 2024, është 4%, krahasuar me vitet paraprake.

Eksportet gjatë vitit 2024, në Sektorin-C, dominohen nga nën sektori “Prodhi i produkteve të gomës dhe të plastikës” edhe pse ka pas një rënie të lehtë për 0.67%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet e gomës dhe plastikës kryesisht janë eksportuar në Gjermani me 20%, në Zvicër me 15% dhe Maqedoninë e Veriut me 10% etj.

Në vendin e dytë, me pjesëmarrje në eksport, radhitet nën sektori “Prodhi i produkteve të fabrikuar metalike”, me pjesëmarrje prej 14.3%, krahasuar me vitin 2023, ky nën sektor, ka pasur rritje për 25.6%. Vendet me të cilat është realizuar më së tepërmi eksporti nga ky nën sektor janë: në Gjermani me 17%, në Kazakistan me 14%, në Zvicër me 13.6% etj.

Në vendin e tretë radhitet nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore” me pjesëmarrje prej 10.5%, në kuadër të Sektorit-C, ndërsa ky nën sektor ka shënuar rritje për 5.5%, krahasuar me vitin 2023. Prodhimet e këtij nën sektori kryesisht janë eksportuar në Shqipëri me 24%, në Maqedoninë e Veriut me 14% dhe në Serbi me 9% etj.

Nën sektori “Prodhi i mobileve”, edhe pse renditet e katërta me pjesëmarrje prej 10%, por ka shënuar një rënie të konsiderueshme për 42% krahasuar me vitin 2023, si pasojë e rënies së eksportit të dyshekëve. Eksporti i këtyre produkteve kryesisht është realizuar në Zvicër me 25%, USA me nga 16% dhe në Gjermani me 15% etj.

Në kuadër të nën sektorëve, i pesti me radhë në eksporte është nën sektori “Prodhi i pijeve” me 9%, i cili në vitin 2024 ka shënuar rritje për 26%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet e pijeve janë eksportuar në Shqipëri për 40.5%, Maqedoninë e Veriut me 20% etj.

Nën sektorin “Prodhi i Metaleve”, në kuadër të Sektorit-C merr pjesë me 8.4% dhe me rritje në eksport prej 2.2%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet e metaleve më së shumti janë eksportuar në Maqedoninë e Veriut me 25.6, Serbi 20% dhe në Shqipëri me 10.5% etj.

• Importet, Sektori-C

Totali i importeve në Kosovë, nga vendet e BE-së , CEFTA-së , EFTA-së dhe nga vendet tjera, për vitin 2024, është 6.4 miliard euro, ndërsa Sektori-C ka marrë pjesë në vlerë prej 5.7 miliard euro, apo rreth 89%.

Sektori-C, në importin e përgjithshëm merr pjesë me 89%.

Importet gjatë vitit 2024, në Sektorin-C, dominohen nga nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore” me 14.4%, krahasuar me vitin 2023, ky nën sektor ka pasur rritje për 10.5%. Këto produkte janë importuar nga Gjermania për 11%, Italia me 9%, Polonia me 8%, Turqia me 7.7% etj.

Nën sektori “Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysmë rimorkio”, radhitet në vendin e tretë në import, me pjesëmarrje prej 12.4% dhe ka shënuar rritje për 25%, krahasuar me vitin 2023. Produktet e këtyre mjeteve motorike më së shumti janë importuar nga Gjermania për 71% etj.

Në vendin e tretë radhitet nën sektori “Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës”, me pjesëmarrje prej 11.4% në importe të Sektorit-C edhe pse kishte rënie të lehtë për 1%, nga viti paraprak. Këto produkte janë importuar më së shumti nga Greqia për 32%, Arabia Saudite për 27.5% etj.

Në vendin e katërt radhitet nën sektori “Prodhimi i Metaleve”, me pjesëmarrje në Sektorin-C me 8% dhe me rritje për 5.2%, nga viti paraprak. Këto produkte janë importuar nga Turqia për 37%, Shqipëria për 22.5% etj.

Të dhënat në tabelën nr.4, paraqesin një pasqyrim të vlerave të importit dhe eksportit me vendet e CEFTA-së, EFTA-së, BE-së dhe me vendet e tjera, për nën sektorët e Sektorit-C, për vitet 2023-2024.

Tabela 4. Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e CEFTA-së, EFTA-së, BE-së dhe Vendet tjera 2023– 2024

Kodi	Industria Përpunues, Sektori-C	Eksporti		Balanci		Importi		Balanci	
		2023	2024	Ndryshimi (2023-2024)	Ndryshimi ne % (2023-2024)	2023	2024	Ndryshimi (2023-2024)	Ndryshimi ne % (2023-2024)
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	73,554,932.28	77,580,910.04	4,025,977.76	5.47	735,216,315.74	812,088,207.65	76,871,891.91	10.46
11	Prodhimi i pijeve	54,115,565.27	68,139,419.57	14,023,854.30	25.91	144,149,126.94	145,535,077.41	1,385,950.47	0.96
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	260,768.41	-	(260,768.41)	(100.00)	111,966,950.78	132,433,584.74	20,466,633.96	18.28
13	Prodhimi i Tekstilit	17,947,435.12	24,707,398.52	6,759,963.40	37.67	103,127,636.05	103,915,233.48	787,597.43	0.76
14	Prodhimi i veshjeve	27,952,647.47	32,911,521.44	4,958,873.97	17.74	196,928,805.93	219,265,012.52	22,336,206.59	11.34
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurë	5,560,451.11	5,736,004.61	175,553.50	3.16	74,909,859.76	79,634,654.69	4,724,794.93	6.31
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie.....	13,544,131.21	15,557,578.72	2,013,447.51	14.87	76,942,957.25	83,284,290.35	6,341,333.10	8.24
17	Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letërës	7,771,090.18	9,373,840.40	1,602,750.22	20.62	98,128,525.14	96,332,134.86	(1,796,390.28)	(1.83)
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	-	-	-	-	46,778.35	13,586.00	(33,192.35)	(70.96)
19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	12,958,487.75	6,561,387.90	(6,397,099.85)	(49.37)	642,199,442.33	641,581,257.32	(618,185.01)	(0.10)
20	Prodhimi i produkteve kimike	28,251,927.46	34,452,496.49	6,200,569.03	21.95	335,694,234.49	354,939,924.04	19,245,689.55	5.73
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	1,367,004.74	2,131,309.55	764,304.81	55.91	110,805,306.91	152,303,918.66	41,498,611.75	37.45
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	117,169,886.75	116,389,492.86	(780,393.89)	(0.67)	234,134,248.44	251,637,085.52	17,502,837.08	7.48
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	24,965,606.40	31,516,871.41	6,551,265.01	26.24	275,461,173.66	277,486,803.09	2,025,629.43	0.74
24	Prodhimi i Metaleve	60,966,557.74	62,363,330.70	1,396,772.96	2.29	423,650,769.83	445,700,846.79	22,050,076.96	5.20
25	Prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike	79,062,813.57	106,289,566.74	27,226,753.17	34.44	281,983,342.46	195,959,255.76	(86,024,086.70)	(30.51)

26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	6,960,390.89	7,698,278.65	737,887.76	10.60	145,442,648.88	157,904,597.59	12,461,948.71	8.57
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	13,095,358.11	15,436,132.02	2,340,773.91	17.87	194,984,563.04	211,946,504.69	16,961,941.65	8.70
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	15,903,264.56	20,607,303.06	4,704,038.50	29.58	342,838,472.34	416,644,902.62	73,806,430.28	21.53
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysme rimorkio	8,417,962.43	9,353,200.92	935,238.49	11.11	558,518,390.76	699,528,020.85	141,009,630.09	25.25
30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	485,476.47	687,990.71	202,514.24	41.71	12,205,363.99	16,725,760.22	4,520,396.23	37.04
31	Prodhimi i mobileve	130,576,131.10	75,684,446.95	(54,891,684.15)	(42.04)	62,950,837.28	67,510,582.00	4,559,744.72	7.24
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	11,981,685.90	16,287,972.94	4,306,287.04	35.94	92,979,002.47	93,404,227.28	425,224.81	0.46
	Gjithsej	712,869,574.92	739,466,454.20	26,596,879.28	3.73	5,255,264,752.82	5,655,775,468.11	400,510,715.29	7.62

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DI/ DPI

2.1. Eksporti dhe importi me vendet e BE-së

Eksportet me vendet e BE-së, për vitin 2024, janë në vlerë prej 281.6 milion euro, që do të thotë se kanë shënuar rritje për 16%, ndërsa vlera e importit është 2.6 miliard euro dhe paraqet rritje në importe për rreth 13%.

Bazuar në tabelën nr. 5, në totalin e shkëmbimeve tregtare për vitin 2024, eksporti merr pjesë me rreth 30%, ndërsa importi me 41%. Mund të themi se kemi një trend në rritje të eksporteve.

Tabela 5. Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e BE-së, përfshirë Mbretërinë e Bashkuar për vitin 2023– 2024

Kodi	Industria Përpunues, Sektori-C	Eksporti		Balanci		Importi		Balanci	
		2023	2024	Ndryshimi (2023-2024)	Ndryshimi ne % (2023-2024)	2023	2024	Ndryshimi (2023-2024)	Ndryshimi ne % (2023-2024)
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	22,448,655.95	23,126,626.36	677,970.41	3.02	391,848,254.83	472,141,942.14	80,293,687.31	20.49
11	Prodhimi i pijeve	12,315,521.09	15,911,024.66	3,595,503.57	29.19	66,257,913.12	88,420,425.12	22,162,512.00	33.45
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	-	-	-	-	79,295,018.17	104,719,633.00	25,424,614.83	32.06
13	Prodhimi i Tekstilit	7,386,194.21	5,857,875.39	-1,528,318.82	(20.69)	8,731,324.59	6,869,284.22	(1,862,040.37)	(21.33)
14	Prodhimi i veshjeve	9,969,920.37	12,221,920.98	2,252,000.61	22.59	9,295,248.36	10,473,587.22	1,178,338.86	12.68
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurë	3,144,586.55	3,487,417.08	342,830.53	10.90	5,243,104.31	4,920,042.50	(323,061.81)	(6.16)

16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie.....	7,597,672.37	8,574,325.06	976,652.69	12.85	29,123,022.25	34,220,792.02	5,097,769.77	17.50
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	1,913,090.42	2,190,212.54	277,122.12	14.49	37,337,378.98	39,163,219.07	1,825,840.09	4.89
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	-	-	-	-	17,324.96	13,586.00	(3,738.96)	(21.58)
19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	4,696.87	393,069.60	388,372.73	8268.76	271,985,590.37	274,686,937.58	2,701,347.21	0.99
20	Prodhimi i produkteve kimike	16,162,768.83	20,001,856.32	3,839,087.49	23.75	167,019,376.57	184,850,745.25	17,831,368.68	10.68
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	79,800.00	201,600.00	121,800.00	152.63	75,023,753.48	94,515,457.13	19,491,703.65	25.98
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	69,602,654.84	63,876,159.98	-5,726,494.86	(8.23)	112,870,304.73	120,138,268.12	7,267,963.39	6.44
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	6,773,181.95	8,315,370.66	1,542,188.71	22.77	93,375,973.77	95,544,525.93	2,168,552.16	2.32
24	Prodhimi i Metaleve	7,179,120.41	16,258,558.06	9,079,437.65	126.47	84,402,222.21	69,213,362.23	(15,188,859.98)	(18.00)
25	Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike	35,825,473.65	42,786,202.13	6,960,728.48	19.43	76,506,298.94	75,642,819.22	(863,479.72)	(1.13)
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	2,129,936.71	3,318,648.18	1,188,711.47	55.81	35,811,702.60	38,689,098.73	2,877,396.13	8.03
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	5,611,794.63	5,281,754.50	-330,040.13	(5.88)	67,959,298.32	68,010,051.09	50,752.77	0.07

28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	4,282,297.97	3,744,433.01	-537,864.96	(12.56)	147,256,697.85	170,074,203.70	22,817,505.85	15.50
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysme rimorkio	3,865,989.96	4,239,673.68	373,683.72	9.67	487,426,385.14	613,773,927.80	126,347,542.66	25.92
30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	389,523.16	435,951.40	46,428.24	11.92	3,598,151.29	4,686,910.68	1,088,759.39	30.26
31	Prodhimi i mobileve	15,884,652.72	27,816,412.43	11,931,759.71	75.12	15,343,572.86	13,176,337.31	(2,167,235.55)	(14.12)
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	10,122,737.42	13,601,439.00	3,478,701.58	34.37	31,757,586.24	19,843,157.86	(11,914,428.38)	(37.52)
	Gjithsej	242,690,270.08	281,640,531.02	38,950,260.94	16.05	2,297,485,503.94	2,603,788,313.91	306,302,809.97	13.33

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga /DI/DPI

• Eksportet me vendet e BE-së

Në vendin e parë, me pjesëmarrje në eksport me vendet e BE-së, radhitet nën sektori “Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës” me 22%, derisa ka shënuar rënie në eksport për 8%. Vendi në të cilin janë eksportuar më së shumti produktet e gomës dhe plastikes janë në Gjermani me 36%.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve të fabrikuarra metalike”, merr pjesë me 15%, në totalin e eksporteve me vendet e BE-së, ndërsa krahasuar me vitin paraprak ka shënuar rritje për 19.5%. Ky eksport, kryesisht është realizuar në Gjermani me 42.5%, Mal të Zi me 20%, Holandë me 18%, etj.

Në vitin 2024, nën sektori “Prodhimi i mobileve” merr pjesë me 10% dhe ka shënuar rritje të konsiderueshme për 75%. Eksportet e produkteve të mobiljeve, më së shumti janë eksportuar në Gjermani me 47%, Suedi 10% etj.

Rritje të eksportit në vendet e BE-së, në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023, ka shënuar nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore” për 3%. Në totalin e eksporteve të Sektorit-C, me vendet e BE-së, ky nën sektor merr pjesë me 8%. Produktet e këtij nën sektori janë eksportuar në Gjermani me 30%, Austri me 10%, Itali 9% etj.

- **Importet me vendet e BE-së**

Nga të dhënat e paraqitura në Tabelën nr. 5 vërehet se nga 23 nën sektorë, vetëm 17 prej tyre kanë rritje në import me vendet e BE-së gjatë vitit 2024, përderisa rënie kanë shënuar gjashtë nën sektorët të Sektorit C.

Nën sektori “Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysmë rimorkio”, në vitin 2024 në importin me vendet e BE-së, në kuadër të Sektorit C merr pjesë me 23.5% dhe ka shënuar rritje për 26%, produktet e mjeteve motorike janë importuar kryesisht nga Gjermania me 81% etj.

Nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore”, merr pjesë në importe me 18% në kuadër të Sektorit C, por në vitin 2024 ka shënuar rritje në importe për 20.5%. Produktet ushqimore janë importuar nga Gjermania me 18.5%, Italia me 15%, Polonia me 14%, Kroacia për 9% etj.

Nën sektori “Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës”, në kuadër të Sektorit-C, me pjesëmarrje në importe me vendet e BE-së, është 10.5%, me rritje për 1% në vitin 2024. Importi është realizuar kryesisht nga Greqia për 76% etj.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve kimike” merr pjesë me 7% në totalin e importeve me vendet e BE-së, në kuadër të Sektorit C. Në vitin 2024, ka shënuar rritje në importe për 11%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet kimike importohen nga Gjermania për 25%, Italia për 12%, Polonia për 7%, Franca për 6.8% etj.

Nën sektori “Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t” merr pjesë në importe të vendeve të BE-së me 6.5%, me rritje importi në 2024 prej 15.5%. Importin më të lartë e ka realizuar Gjermania me 39.5% dhe Italia me 28.5%, etj.

2.2. Eksporti dhe importi me vendet e CEFTA-së

Në Tabelën nr.6 janë pasqyruar vlerat e importit dhe eksportit me vendet e CEFTA-së për nën sektorët (10 deri 33) në kuadër të Sektorit-C.

Në përgjithësi, eksportet me vendet e CEFTA-së, në kuadër të Sektorit C, në vitin 2024, kanë shënuar rritje për 10%, ndërsa importi ka shënuar rënie për 15%.

Tabela 6. Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e CEFTA-së për sektorët e industrisë, 2023 – 2024

Kodi	Industria Përpunues, Sektori-C	Eksporti		Balanci		Importi		Balanci	
		2023	2024	Ndryshimi (2023-2024)	Ndryshimi ne % (2023-2024)	2023	2024	Ndryshimi (2023-2024)	Ndryshimi ne % (2023-2024)
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	42,379,637.78	43,895,522.42	1,515,884.64	3.58	131,356,038.49	118,777,766.09	(12,578,272.40)	(9.58)
11	Prodhimi i pijeve	37,410,598.07	46,221,948.07	8,811,350.00	23.55	70,298,822.02	48,054,267.64	(22,244,554.38)	(31.64)
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	59,857.60	-	-	-	2,542,478.63	3,617,604.86	1,075,126.23	42.29
13	Prodhimi i Tekstilit	6,580,889.61	12,001,724.51	5,420,834.90	82.37	1,640,500.64	1,377,564.25	(262,936.39)	(16.03)
14	Prodhimi i veshjeve	2,445,468.15	2,197,421.21	(248,046.94)	(10.14)	1,564,065.34	1,188,258.54	(375,806.80)	(24.03)
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurë	1,109,628.89	816,839.18	(292,789.71)	(26.39)	988,985.84	1,370,743.23	381,757.39	38.60
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie.....	4,355,435.85	4,423,730.96	68,295.11	1.57	20,520,760.17	17,727,511.99	(2,793,248.18)	(13.61)

17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	5,600,087.91	6,893,935.38	1,293,847.47	23.10	29,104,000.31	28,822,074.10	(281,926.21)	(0.97)
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	-	-	-	-	-	-	-	-
19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	12,952,280.88	6,168,225.93	(6,784,054.95)	(52.38)	51,658,435.34	26,340,058.11	(25,318,377.23)	(49.01)
20	Prodhimi i produkteve kimike	9,995,486.20	11,939,724.85	1,944,238.65	19.45	35,459,558.60	35,020,993.28	(438,565.32)	(1.24)
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	1,050,212.83	1,549,419.80	499,206.97	47.53	12,474,825.28	15,801,061.16	3,326,235.88	26.66
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	24,375,335.38	31,301,320.03	6,925,984.65	28.41	36211770.93	31664896.66	(4,546,874.27)	(12.56)
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	11,630,969.03	11,698,330.75	67,361.72	0.58	90,409,136.87	88,244,206.51	(2,164,930.36)	(2.39)
24	Prodhimi i Metaleve	49,168,650.53	41,848,599.51	(7,320,051.02)	(14.89)	178,370,236.63	136,743,854.98	(41,626,381.65)	(23.34)
25	Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike	21,956,799.59	28,556,071.34	6,599,271.75	30.06	28,328,284.10	31,217,209.80	2,888,925.70	10.20
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	2,683,421.28	2,369,548.95	(313,872.33)	(11.70)	367,677.52	68,622.63	(299,054.89)	(81.34)
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	4,928,140.16	6,375,127.48	1,446,987.32	29.36	16,247,983.11	17,961,228.79	1,713,245.68	10.54
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	8,983,631.45	11,566,009.02	2,582,377.57	28.75	6,612,160.05	6,291,809.99	(320,350.06)	(4.84)

29	Prodhi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysme rimorkio	1,791,309.45	2,429,001.39	637,691.94	35.60	2,028,225.81	438,005.14	(1,590,220.67)	(78.40)
30	Prodhi i mjeteve tjera të transportit	55,635.86	227,571.85	171,935.99	309.04	45,256.57	88,351.96	43,095.39	95.22
31	Prodhi i mobileve	8,717,592.01	10,668,215.61	1,950,623.60	22.38	7,951,629.74	5,949,862.94	(2,001,766.80)	(25.17)
32	Prodhi tjetër p.k.t.	1,276,200.96	2,050,455.13	774,254.17	60.67	2,265,618.77	624,914.00	(1,640,704.77)	(72.42)
	Gjithsej	259,507,269.47	285,198,743.37	25,691,473.90	9.90	726,446,450.76	617,390,866.63	(109,055,584.13)	(15.01)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DI/ DPI

Eksporti me vendet e CEFTA-së

Eksportet me vendet e CEFTA-së, në Sektorin-C, gjatë vitit 2024, dominohen nga nën sektori “Prodhi i Pijeve”, me pjesëmarrje prej 16%. Në vitin 2024, ky nën sektor ka shënuar rritje në eksport për 24% krahasuar me vitin paraprak. Vendet në të cilat janë eksportuar më së shumti produktet e metaleve janë: në Shqipëri me 60%, etj.

Nën sektori ”Prodhi i produkteve ushqimore” merr pjesë në eksporte me këto vende me 15%. Ky nën sektor ka shënuar rritje në eksport për 4% krahasuar me vitin 2023. Produktet ushqimore janë eksportuar kryesisht në Shqipëri me 43%, në Maqedoninë e Veriut me 24%, etj.

Pjesëmarrja e nën sektorit të “Prodhimi i Metaleve ” në eksportet e Sektorit-C me vendet e CEFTA-së është 15%. Në vitin 2024, ky nën sektor ka shënuar rënie për 15% krahasuar me vitin paraprak. Produktet e këtij nën sektori janë eksportuar në Shqipëri 38%, në Serbi 33%, etj.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve nga goma dhe plastika”, në kuadër të Sektorit-C, në eksport merr pjesë me 11%. Ky nën sektor ka shënuar rritje në eksport për 28% krahasuar me vitin paraprak. Vendet me të cilat janë eksportuar më së shumti produktet e gomës dhe plastikës janë Maqedonia e Veriut me 38%, Shqipëria me 30%, etj.

Rritje në eksporte për 30% ka shënuar nën sektori “Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike”, por me pjesëmarrje të ulët në Sektorin-C për vetëm 10%. Vendet ku janë eksportuar këto produkte janë Shqipëria me 34%, Mal i Zi me 30%, etj.

- **Importi me vendet e CEFTA-së**

Importet e Kosovës me vendet e CEFTA-së, në vitin 2024, karakterizohen me rënie të theksuar të produkteve nga Sektori-C (Industria Përpunuese), në numrin më të madh të nën sektorëve.

Në kuadër të nën sektorëve të Sektorit C, pjesëmarrjen më të lartë në importe me vendet e CEFTA-së e ka nën sektori “Prodhimi i metaleve” me 22%. Në vitin 2024, ky nën sektor ka shënuar rënie në import për 23.3% krahasuar me vitin 2023. Produktet e metaleve kryesisht janë importuar nga Shqipëria për 73%, Maqedonia e Veriut për 17%, etj.

Nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore” merr pjesë në importe me vendet e CEFTA-së me 19%. Por në vitin 2024 ka shënuar rënie të importit për 9%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet ushqimore janë importuar nga Maqedonia e Veriut për 43%, Serbia për 25% etj.

Në vendin e tretë radhitet nën sektori “Prodhimi i produkteve minerale jo metalike” me pjesëmarrje në importe për 14%. Në vitin 2024 ky nën sektor ka shënuar rënie në import për 2.4%, krahasuar me vitin 2023. Produktet për këtë nën sektor janë importuar nga Shqipëria për 51%, Maqedonia e Veriut 43.4%, etj.

Rënie më të lartë në importet me vendet e CEFTA-së, në kuadër të Sektorit C, gjatë vitit 2024, ka shënuar nën sektori “Prodhimi i pijeve” për 32%, krahasuar me vitin 2023. Pijet janë importuar nga Maqedonia e Veriut për 55%, Shqipëria për 28% etj.

2.3 Eksporti dhe Importi me vendet e EFTA-së

Eksportet e Kosovës me shtetet anëtare të EFTA-së, për vitin 2024, kanë shënuar vlerën prej 80 milion euro, rritje prej 12%, derisa importet kanë shënuar vlerën prej 40 milion euro, rritje për 14% krahasuar me vitin 2023.

Tabela 7. Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e EFTA-së për sektorët e industrisë, 2023 - 2024

Kodi	Industria Përpunues, Sektori-C	Eksporti		Balanci		Importi		Balanci	
		2023	2024	Ndryshimi (2023-2024)	Ndryshimi ne % (2023-2024)	2023	2024	Ndryshimi (2023-2024)	Ndryshimi ne % (2023-2024)
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	1,645,826.62	1,532,128.48	(113,698.14)	(6.91)	1,509,278.38	1,797,335.82	288,057.44	19.09
11	Prodhimi i pijeve	2,253,982.33	3,088,016.43	834,034.10	37.00	187,973.02	90,001.03	(97,971.99)	(52.12)
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	-	-	-	-	4,821,480.77	5,783.82	(4,815,696.95)	(99.88)
13	Prodhimi i Tekstilit	321,227.53	676,818.38	355,590.85	110.70	272,177.18	99,636.11	(172,541.07)	(63.39)
14	Prodhimi i veshjeve	656,603.05	715,735.70	59,132.65	9.01	1,256,303.04	1,159,263.91	(97,039.13)	(7.72)
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurë	671,524.37	742,910.56	71,386.19	10.63	603,861.47	722,257.03	118,395.56	19.61
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie.....	1,572,531.66	2,502,682.29	930,150.63	59.15	858,065.80	1,135,403.88	277,338.08	32.32
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	114,085.21	138,733.93	24,648.72	21.61	375,380.35	356,352.51	(19,027.84)	(5.07)

18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	-	-	-	-	-	-	-	-
19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	1,510.00	43.90	(1,466.10)	(97.09)	214,235.53	452,542.63	238,307.10	111.24
20	Prodhimi i produkteve kimike	1,572,156.10	1,360,783.00	(211,373.10)	(13.44)	2,535,660.29	2,226,972.99	(308,687.30)	(12.17)
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	-	3.50	-	-	2,244,361.24	8,862,653.68	6,618,292.44	294.89
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	17,584,501.33	17,039,828.13	(544,673.20)	(3.10)	1579510.67	1714216.585	134,705.92	8.53
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	5,264,159.18	5,689,885.08	425,725.90	8.09	940,258.51	1,104,737.97	164,479.46	17.49
24	Prodhimi i Metaleve	3,177,458.16	3,098,128.82	(79,329.34)	(2.50)	1,480,396.80	1,662,972.45	182,575.65	12.33
25	Prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike	13,653,159.67	15,101,322.02	1,448,162.35	10.61	2,806,987.24	3,269,973.56	462,986.32	16.49
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	627,033.77	780,344.56	153,310.79	24.45	2,463,111.09	2,329,385.20	(133,725.89)	(5.43)
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	2,212,921.71	3,543,937.77	1,331,016.06	60.15	2,016,866.83	1,283,906.09	(732,960.74)	(36.34)
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	684,324.01	559,296.25	(125,027.76)	(18.27)	4,601,433.37	7,270,026.24	2,668,592.87	57.99
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysme rimorkio	581,758.25	727,696.58	145,938.33	25.09	403,928.11	701,547.17	297,619.06	73.68

30	Prodhimi I mjeteve tjera të transportit	40,267.45	23,955.46	(16,311.99)	(40.51)	316,056.60	325,087.54	9,030.94	2.86
31	Prodhimi i mobileve	18,378,445.83	22,107,028.78	3,728,582.95	20.29	1,149,010.96	1,222,812.00	73,801.04	6.42
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	466,215.54	367,678.05	(98,537.49)	(21.14)	2,726,664.88	2,449,799.63	(276,865.25)	(10.15)
	Gjithsej	71,479,691.77	79,796,957.67	8,317,265.90	11.64	35,363,002.13	40,242,667.85	4,879,665.72	13.80

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DI/ DPI

- Eksporti me vendet e EFTA-së**

Nën sektori “Prodhimi i mobiljeve”, në vitin 2024, në kuadër të Sektorit-C, merr pjesë në eksportet me vendet e EFTA-së me 28%. Ndërsa, në kuadër të nën sektorit ka shënuar rritje për 20%, krahasuar me vitin 2023. Eksporti i këtyre produkteve më së shumti është realizuar në Zvicër me 99.5%.

Në vendin e dytë me eksporte, në vendet e EFTA-së, radhitet nën sektori “Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës” me pjesëmarrje prej 21%, në kuadër të Sektorit C. Në vitin 2024 ky nën sektor ka shënuar rënie për 3%, krahasuar me vitin 2024, produktet e këtij nën sektori, janë eksportuar në Zvicër me 99.9%.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike”, me vendet e EFTA-së, ka pjesëmarrje për 18%. Ky nën sektor në vitin 2024, ka shënuar rritje të eksportit për 10.6% krahasuar me vitin paraprak, produktet e këtij nën sektori kanë shënuar eksportin më të lartë në Zvicër me 92%.

- **Importi me vendet e EFTA-së**

Importet me vendet e EFTA-së, dominohen me pjesëmarrje prej 22% në importet nga nën sektori “Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike”.

Në vitin 2024 ka shënuar rritje të konsiderueshme mbi 100% krahasuar me vitin paraprak. Këto produkte janë importuar nga Zvicra me 98%.

Nën sektori “Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.” rrëdhitet e dyta me pjesëmarrje me 18%. Në vitin 2024, ky nën sektor ka shënuar rritje për 58%, krahasuar me vitin 2023. Makineritë janë importuar nga Zvicra me 97%.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike.”, merr pjesë në importe me 8%, ndërsa në kuadër të nën sektorit, në vitin 2024, ka shënuar rritje për 16.5% krahasuar me vitin paraprak. Këto produkte janë importuar nga Zvicra me 94.5%.

2.4. Eksporti dhe Importi me vendet tjera

Eksportet me vendet tjera për vitin 2024, kanë shënuar vlerën prej 92.8 milion euro, perderisa në vitin 2023 kanë shënuar rënie të konsiderueshme për 33%.

Importet me vendet tjera, për vitin 2024, kanë shënuar vlerën prej 2.4 miliard euro, krahasuar me vitin 2023, një rritje për 9%.

Tabela 8. Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e tjera për vitin 2023 - 2024

Kodi	Industria Përpunues, Sektori-C	Eksporti		Bilanci		Importi		Bilanci	
		2023	2024	Ndryshimi (2023-2024)	Ndryshimi ne % (2023-2024)	2023	2024	Ndryshimi (2023-2024)	Ndryshimi ne % (2023-2024)
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	7,080,811.93	9,026,632.78	1,945,820.85	27.48	210,502,744.04	219,371,163.60	8,868,419.56	4.21
11	Prodhimi i pijeve	2,135,463.78	2,918,430.41	782,966.63	36.66	7,404,418.78	8,970,383.62	1,565,964.84	21.15
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	200,910.81	-	-	-	25,307,973.21	24,090,563.06	(1,217,410.15)	(4.81)
13	Prodhimi i Tekstilit	3,659,123.77	6,170,980.24	2,511,856.47	68.65	92,483,633.64	95,568,748.91	3,085,115.27	3.34
14	Prodhimi i veshjeve	14,880,655.90	17,776,443.55	2,895,787.65	19.46	184,813,189.19	206,443,902.85	21,630,713.66	11.70
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurë	634,711.30	688,837.79	54,126.49	8.53	68,073,908.14	72,621,611.93	4,547,703.79	6.68
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie.....	18,491.33	56,840.41	38,349.08	207.39	26,441,109.03	30,200,582.46	3,759,473.43	14.22

17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	143,826.64	150,958.55	7,131.91	4.96	31,311,765.50	27,990,489.17	(3,321,276.33)	(10.61)
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	-	-	-	-	29,453.39	-	-	-
19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	-	48.47	-	-	318,341,181.09	340,101,719.00	21,760,537.91	6.84
20	Prodhimi i produkteve kimike	521,516.33	1,150,132.32	628,615.99	120.54	130,679,639.03	132,841,212.53	2,161,573.50	1.65
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	236,991.91	380,286.25	143,294.34	60.46	21,062,366.91	33,124,746.69	12,062,379.78	57.27
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	5,607,395.20	4,172,184.72	(1,435,210.48)	(25.59)	83,472,662.11	98,119,704.16	14,647,042.05	17.55
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	1,297,296.24	5,813,284.92	4,515,988.68	348.11	90,735,804.51	92,593,332.67	1,857,528.16	2.05
24	Prodhimi i Metaleve	1,441,328.64	1,158,044.31	(283,284.33)	(19.65)	159,397,914.19	238,080,657.14	78,682,742.95	49.36
25	Prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike	7,627,380.66	19,845,971.25	12,218,590.59	160.19	174,341,772.18	85,829,253.18	(88,512,519.00)	(50.77)
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	1,519,999.13	1,229,736.96	(290,262.17)	(19.10)	106,800,157.67	116,817,491.02	10,017,333.35	9.38
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	342,501.61	235,312.27	(107,189.34)	(31.30)	108,760,414.78	124,691,318.71	15,930,903.93	14.65
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	1,953,011.13	4,737,564.78	2,784,553.65	142.58	184,368,181.07	233,008,862.70	48,640,681.63	26.38

29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysme rimorkio	2,178,904.77	1,956,829.27	(222,075.50)	(10.19)	68,659,851.70	84,614,540.75	15,954,689.05	23.24
30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	50.00	512.00	462.00	924.00	8,245,899.53	11,625,410.04	3,379,510.51	40.98
31	Prodhimi i mobileve	87,595,440.54	15,092,790.13	(72,502,650.41)	(82.77)	38,506,623.72	47,161,569.74	8,654,946.02	22.48
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	116,531.98	268,400.76	151,868.78	130.32	56,229,132.58	70,486,355.79	14,257,223.21	25.36
	Gjithsej	139,192,343.60	92,830,222.14	(46,362,121.46)	(33.31)	2,195,969,795.99	2,394,353,619.72	198,383,823.73	9.03

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DI/ DPI

- **Eksporti me vendet tjera**

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në tab. nr.8, vërehet se eksportet me vendet tjera, i paraprinë nën sektori “Prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike”, në kuadër të Sektorit-C merr pjesë në eksporte me 21%, ndërsa në vitin 2024 kanë shënuar rritje të theksuar mbi 100% krahasuar me vitin paraprak. Produktet e prodhuara nga ky nën sektor kryesisht janë eksportuar në Kazakistan për 77%.

Nën sektori “Prodhimi i veshjeve”, renditet e dyta me pjesëmarrje për 19%, me një rritje për 20% krahasuar me vitin 2023. Vendet ku ka eksportuar janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës me 67%.

Nën sektori “Prodhimi i mobiljeve” merr pjesë në eksporte me vendet e tjera me 16%, ndërsa ka pësuar rënie të konsiderushme për 83% të eksporteve në vitin 2024 krahasuar me vitin paraprak. Produktet e mobiljeve eksportohen në SHBA me 92%, etj.

- **Importi me Vendet tjera**

Në kuadër të Sektorit-C, nën sektori “Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës”, në import merr pjesë me 14%, ndërsa në vitin 2024, ky nën sektor ka shënuar rritje për 7% krahasuar me vitin 2023, këto produkte janë importuar nga Arabia Saudite për 52%, SHBA për 12%, Turqia për 10%, etj.

Nën sektori “Prodhimi i Metaleve”, radhitet i dyti në importe me pjesëmarrje prej 10%, në kuadër të Sektorit-C, në vitin 2024. Ky nën sektor ka shënuar rritje të importeve për 49% krahasuar me vitin 2023. Produktet e metaleve janë importuar nga Turqia për 70% etj.

Nën sektori “Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.”, merr pjesë në importe me 10% dhe me rritje prej 26.3% në vitin 2024, krahasuar me vitin paraprak. Makineritë janë importuar nga Kina për 58%, nga Turqia 28% etj.

ANALIZA SOCIALE

Fuqia punëtore

Sipas ligjit të punës në Kosovë, marrëdhënia e punës mund të themelohet me çdo person prej moshës tetëmbëdhjetë (18) vjeçare. Fuqia punëtore përbëhet nga personat e punësuar dhe personat e papunë, ndërsa personat joaktivë nuk konsiderohen pjesë e fuqisë punëtore. Norma e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është përqindja e popullsisë në moshë pune e një vendi, që angazhohet në mënyrë aktive në tregun e punës.

Sipas raportit të BQK-së, referuar (Anketës së Fuqisë Punëtore të ASK-së), shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore në vitin 2024 ishte 43.2%, që paraqet rritje vjetore prej 2.5%. Shkalla e punësimit ishte më e lartë se meshkujt, me 55.9%, një rritje vjetore prej 2.5% në krahasim me vitin paraprak, ndërsa, përqindja e grave të punësuar ishte 21.2%, një rritje vjetore prej 1.4.% në krahasim me vitin 2023.

Statistikat zyrtare të tregut të punës tregojnë se shkalla mesatare e papunësisë në vitin 2024 ishte 10.8%, një nivel më i ulët sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Në baza gjinore, tregu i punës në Kosovë karakterizohet një shkallë më e lartë e papunësisë tek gratë me 18% në raport me meshkujt prej 7.7%. Sidoqoftë, edukimi ka përmirësuar perspektivat në tregun e punës në Kosovë, ku shkalla e papunësisë më e lartë është për personat pa shkollim rreth 55.9%, ndërsa më e ulëta për ata me arsimim të lartë (terciar) prej 6.5%.

Pjesëmarrja e Sektorit-C, në punësim të përgjithshëm, numër të ndërmarrjeve dhe qarkullim vjetor

Në këtë pjesë të raportit janë analizuar të dhënat që kanë të bëjnë me numrin e ndërmarrjeve, numrin e të punësuarve dhe qarkullimin në tri vitet e fundit, përveç paraqitjes së të dhënave statistikore, analizat tregojnë edhe për trendët e rënies apo ngritjes të punësimit, ndërmarrjeve dhe qarkullimit vjetor në industri.

Të dhënat krahasuese në tabelën nr. 9 tregojnë se, gjatë tri viteve të fundit, është shënuar rritje vetëm në punësim, ndërsa në numrin e ndërmarrjeve dhe në qarkullim ka pas rënie në vitin 2024 krahasuar me vitin paraprak.

SpektoriC në normën e punësimit sipas aktivitetit ekonomik merr pjesë me 10.74%.

Të dhënat e analizuara tregojnë se pjesëmarrja e numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve në vitin 2024, ka shënuar rritje prej 5%, në numrin e të punësuarve kemi rënie prej 6.6% dhe rënie në qarkullim vjetor prej 0.8%, krahasuar me vitin 2023. Sektori i prodhimit, bazuar në potencialin që ka, mund të japë kontribut të rëndësishëm në tërë këta tregues por edhe në strukturën e përgjithshme ekonomike të vendit. Megjithatë, sektori i prodhimit po ofron mundësi punësimi relativisht të kufizuar, duke punësuar aktualisht rreth 10.74%, të fuqisë punëtore për vitin 2024, ndërsa viti 2023 me 11.09% nga 10.62% sa ishte në vitin 2022.

Tabela 9. Sektori C, numri i ndërmarrjeve, të punësuarve dhe qarkullimi, 2022-2024

Kodi	Industria Përpunuese Sektori-C	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
		Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	1503	1535	1620	10,931	12,360	8,921	490,162,510.96	561,085,852.31	660,164,389.40
11	Prodhimi i pijeve	102	94	89	2,151	2,327	2,773	156,508,456.41	196,667,417.27	148,014,883.41
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	5	4	9	56	48	37	4,866,541.49	5,839,657.34	5,604,569.61
13	Prodhimi i tekstilit	179	200	205	938	1,151	1,549	28,675,745.45	31,186,657.96	27,601,472.24
14	Prodhimi i veshjeve	397	404	430	1,841	2,118	1,193	18,692,419.49	22,958,140.57	28,116,087.29
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	39	39	32	404	365	360	11,597,152.83	10,527,865.53	10,307,597.18
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës	506	504	507	2,655	2,910	1,965	85,983,088.64	88,625,018.18	108,771,505.13
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	111	120	124	628	827	488	43,321,984.42	50,665,776.87	46,261,876.30
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	174	179	192	1,072	1,235	342	31,049,794.57	33,840,325.42	54,389,149.73
19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	5	6	4	177	186	57	16,482,741.52	15,672,577.76	13,159,608.61
20	Prodhimi i produkteve kimike	123	139	141	1,006	1,127	395	45,075,279.29	51,600,390.37	70,009,989.83
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve far	7	7	7	124	217	471	2,716,465.32	4,661,311.69	5,008,936.04
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	626	670	657	4,035	4,655	3,563	257,367,563.53	278,546,416.86	251,494,648.47
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	547	562	568	5,458	5,851	4,151	439,618,261.48	487,503,084.12	488,371,124.33
24	Prodhimi i Metaleve	122	124	134	875	955	1,207	102,686,591.35	111,455,645.52	144,061,478.22
25	Prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike	790	836	894	3,292	3,869	5,606	198,982,656.43	246,434,152.11	237,150,073.36
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	27	29	27	97	131	189	-	5,072,127.09	4,585,598.30
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	39	44	47	263	306	173	21,635,183.03	23,538,225.43	22,821,912.12
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	34	38	42	289	324	499	9,029,384.12	8,680,562.01	14,896,945.69
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysmë rimorkio	8	6	10	120	119	33	2,151,554.95	2,345,947.16	5,463,654.24
30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	4	3	5	50	54	41	2,091,799.46	1,894,727.98	2,002,673.55
31	Prodhimi i mobileve	600	655	736	5,684	5,739	8,976	249,330,671.03	231,832,198.56	98,649,056.07
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	110	129	144	549	644	438	21,287,159.64	24,259,084.38	24,218,448.92
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	104	117	143	192	250	1,174	4,042,196.70	4,533,136.45	8,515,330.90
	Gjithsejtë	6,162	6,444	6,767	42,887	47,768	44,601	2,243,355,202.11	2,499,426,298.94	2,479,641,008.94

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe ATK, përpunuar nga DI/DPI


Bazuar në të dhënat e prezantuara në tabelën nr.9 sa i përket Sektorit-C, rritjen më të lartë të numrit të ndërmarrjeve e kemi në vitin 2024 me 6,767 ose 323 ndërmarrje më shumë krahasuar me vitin paraprak, ndërsa rënie është shënuar në punësim për 3,167 punëtorë më pak se në vitin 2023. Qarkullimi vjetor në vitin 2024, po ashtu ka shënuar rënie për afër 1%, krahasuar me vitin 2023. Sipas këtyre të dhënave të analizuara në tri vitet e fundit 2022-2024, vërehet se kemi jo qëndrueshmëri në disa tregues ekonomik.

Kontributi i nën sektorëve në punësimin e përgjithshëm të Sektorit-C,

Kontributi i Sektorit të prodhimit/përpunimit në punësimin e përgjithshëm në Kosovë për vitin 2024 është 10.74%, sipas aktivitetit ekonomik.

Punësimi sipas nën sektorëve paraqet kontributin e secilit nën sektor në krijimin e vendeve të punës në kuadër të Sektorit-C, (sektori prodhues/përpunues), i paraqitur si më poshtë.

Figura 7. Kontributi i nën sektorëve në punësimin e Sektorit-C, në % për vitin 2024



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DI/DPI

Bazuar nga të dhënat e paraqitura në figurën nr. 7, kontributin më të lartë në punësim të sektorit prodhues/përpunues në Kosovë, e krijojnë nën sektori “Prodhimi i mobiljeve” me rreth 20.13%, i ndjekur nga nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore” me rreth 20%, ndërsa i treti me kontribut në punësim radhitet nën sektori “Prodhimi produkteve të fabrikuara metalike” me rreth 12.57%.


Nën sektori “prodhimi i produkteve minerale jo metalike” me rreth 9.31%, të kontributit në punësimin e përgjithshëm të Sektorit – C. Të gjithë nën sektorët tjerë kontribuojnë në më pak se 10% e punësimit.

Gratë të punësuar në Sektorin-C

Kosova kishte shkallën më të ulët të pjesëmarrjes së grave në prodhimtari në vend, duke pas parasysh disa barrierat si p.sh mos respektimi i kontratave të punës që karakterizohet ende nga shkalla e lartë e informalitetit dhe kushteve të pa pafavorshme të punës, sidomos punësimit të grave dhe të rinjve.

Deri me tani pjesëmarrja e punësimit të grave sipas të dhënave për vitet 2015-2024, është tejet e ulët sidomos në sektorin e prodhimit, trendi i ngadalshëm i punësimit të grave është përcjell vazhdimisht në vend, por me të dhëna premtuese të rritjes pozitive në punësim sipas gjinisë.

Figura 8: Punësimi gjithëpërfshirës në % (sipas gjinisë), në Kosovë 2015-2024



Burimi: ASK (përpunuar nga DI/DPI-së)

Bazuar në të dhënat e publikuara nga figura nr. 8 vërejmë se punësimi i grave në Kosovë në punësimin e përgjithshëm në vitin 2015 ishte 22.6%, ndërsa në vitin 2024 kishte shënuar rritje në rreth 27.5%, që paraqet rritje prej afro 5%, ndërsa pjesëmarrja e punësimit të grave në totalin e punësimit në prodhim, ishte e ulët në Kosovë, në vitin 2015 me 10.22% dhe në vitin 2024 me 20.3%, që paraqet rritje në favor të punësimit prej 10.1%.

Elasticiteti i punësimit

Ndryshimet globale edhe në tregjet e punës kanë krijuar mundësi të mëdha, që edhe ekonomitë e zhvilluara të kenë vështirësi në ruajtjen e elasticitetit të punësimit. Ndryshimet mund të vijnë edhe nga faktorë të shumtë, qoftë nga krizat që mund të jenë të pa parashikuara, siç ishte me pandeminë Covid-19, por edhe si pasojë e transformimit digjital. Elasticiteti mund të ketë ndryshime në raport me produktivitetin në punë varësisht se nga do të jetë e orientuar norma vjetore e rritjes, qoftë nga punësimi apo nga produktiviteti.

Tabela 10: Elasticiteti i punësimit krahasuar me vendet tjera për vitet 2015-2023

Vendet	Norma vjetore e rritjes së punësimit	Norma vjetore e rritjes së VSHP	EE	Klasifikimi
Shqipëria	3.3%	9.7%	0.34	Drejtuar nga produktiviteti
Bosnja dhe Hercegovina	2.3%	8.3%	0.27	Drejtuar nga produktiviteti
Mali i Zi	1.2%	4.4%	0.28	Drejtuar nga produktiviteti
Maqedonia e Veriut	0.5%	7.1%	0.7	Drejtuar nga produktiviteti
Serbia	3.8%	4.7%	0.81	Drejtuar nga produktiviteti
Kosova	7.8%	5.8%	1.35	Drejtuar nga punësimi
BP6	3.1%	5.9%	0.52	Drejtuar nga produktiviteti

Burimi: VShP - WDI; Punësimi në Prodhim, UNIDO, ASK (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Analiza e paraqitur në tabelën 10, tregon se ndërmjet viteve 2015-2023, sektori i prodhimit në Kosovë u rrit çdo vit me një normë të përbërë prej 5.8%, të produktivitetit në punë në raport me punësimin në industri që ka shënuar rritje prej 7.8%, gjatë të njëjtës periudhë. Sipas këtyre të dhënave vlerësohet se norma e rritjes në Kosovë është e drejtuar (udhëhequr) nga punësimi, gjë që koncentrimi i biznesit ka pas për synim zgjerimin e punësimit në raport me interesimin që të investohet në digjitalizim dhe teknologji të avancuar të prodhimit. Nëse e vështrojmë tabelën 10 në përgjithësi, del se në vendet e Ballkanit Perëndimor e kemi një situatë ku shumica e vendeve normën e rritjes e kanë të drejtuar nga produktiviteti në punë, ndërsa në këtë vit analiza për shtetin e Kosovës na paraqet ndryshim në elasticitetin e punësimit e drejtuar nga norma e rritjes së punësimit konkretisht në hapjen e vendeve të reja të punës. Përqindjet në Vendet e BP6, nuk paraqesin ndonjë diskrepancë të theksuar, por të dhënat në të dy treguesit janë nën 10%, të lartësisë së normës së rritjes.

Pagat në Prodhim

Rritja e produktivitetit të punës përkthehet pozitivisht në rritje të pagave në prodhim. Duke i'u referuar të dhënave nga tabela nr.11, norma e rritjes së produktivitetit në Kosovë në vitin 2022 ishte 7.13% dhe norma e rritjes së pagave me 11.87%, që flet për trend pozitiv të rritjes në normë vjetore të produktivitetit dhe reflektim rritjeje edhe në paga. Shqipëria shënon trend pozitiv në këta dy tregues, normë të rritjes së pagave për 13.08% dhe normë të produktivitetit prej 4.93%. Nëse e bëjmë një analogji me Kosovën, vërejmë se në Kosovë kemi rritje më të shpejtë të normës së produktivitetit ndërsa rritje më të ngadaltë në normën e rritjes së pagave në raport me Shqipërinë. Vlen të theksohet që në këta tregues të analizuar, Kosova qëndron krahas vendeve të BP6, bile në disa prej treguesve qëndron më mirë. Ndërsa, në të gjitha vendet krahasuese të BP6, norma e rritjes së pagave ishte pozitive edhe pse vetëm shteti i Serbisë ka shënuar normë negative vjetore të produktivitetit në punë.

Tabela 11: Pagat për vitin 2022


Vendet	Norma e rritjes së pagave	Norma e rritjes së produktivitetit
Shqipëria	13.08%	4.93%
Bosnja dhe Hercegovina	6.44%	5.73%
Mali i Zi	4.73%	2.67%
Maqedonia e Veriut	6.53%	5.17%
Serbia	9.90%	-0.35%
Kosova	11.87%	7.13%

Burimi: WDI, UNIDO, ASK (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Intensiteti relativ i pagave në industrializim

Ndërmjet viteve 2015 dhe 2022, pagat e sektorit të prodhimit u rritën mesatarisht me rreth 12%. Rritja e fitimeve për punëtorët konfirmohet edhe nga studimi i intensitetit relativ të pagës, i matur si përqindje e pagave të prodhimit si pjesë e VShP-së. Ky tregues mat pjesën e VShP-së që u shkon punëtorëve të sektorit të prodhimit në formë të pagave. Figura 9, më poshtë tregon se intensiteti relativ i pagave në Kosovë është rritur nga 12.25% (2015) në 17.32% (2022). Shkurtimisht, me një sektor prodhimi në rritje, fatura totale e pagave të prodhimit në raport me VSHP-ë, është rritur me intensitet pozitiv, por me ritëm të ngadalshëm edhe përkundër kontributit në faturën e pagës, që mund ta jep sektori prodhues/përpunues në Kosovë. Megjithatë, ajo rezulton ende në intensitetin më të ulët të pagave relative në rajon. Të gjitha vendet krahasuese zënë mesatarisht 40% të peshës së pagave në VSHP.

Figura 9. Intensiteti relativ i pagave të industrisë



Burimi: Indikatorët e Shteteve WDI, UNIDO, ASK-së (përpunuar nga stafi i DI/DPI)

Paga mesatare sipas aktiviteteve ekonomike në Kosovë

Sipas të dhënave të prezantuara në tabelën 12, kemi të paraqitur pagën mesatare për dy vite në sektorin e prodhimit/përpunimit 2023/24, që tregon për përqindje të ulët të rritjes prej vetëm 17.1% në pagën bruto në vitin 2024, krahasuar me vitin paraprak në Kosovë, prandaj efekti është i ngadalshëm edhe në faturën e përgjithshme të pagës në këtë sektor.

Tabela 12 Paga mesatare sipas aktiviteteve ekonomike në Kosovë, 2023-2024, (Euro)

Vitet	Sektori	Bruto	Neto
2023	C - Prodhim	451.00€	404.00€
2024	C - Prodhim	528.00€	451.00€

Burimi: ASK-së (përpunuar nga stafi i DI/DPI)


ANALIZA MJEDISORE

Efiçienca e energjisë në sektorin e prodhimit

Kosova në vitin 2023, vlerën e efiqencës së energjisë në prodhim e kishte 3.73 milion euro për njësi të ktoe (kilo ton për njësi ekuivalente të naftës), është me e ulët se mesatarja e vendeve të BP6 me 4.69 milion euro/ktoe. Vlerën më të lartë të efiqencës së energjisë e kishte Bosnja dhe Hercegovina me 6.07 milion euro/ktoe, ndërsa vlerën më të ulët e ka Mali i Zi prej 2.61 milion euro/ ktoe.

Vlen të theksohet se mesatarja e efiqencës së energjisë për vendet e Ballkanit Perëndimor (BP6) në vitin 2015 ishte 2.75 milion euro/ktoe, ndërsa në vitin 2023 kishte ngritje të efiqencës së energjisë në 4.69 milion euro/ktoe.

Figura 10: Efiçienca e energjisë në sektorin e prodhimit




Burimi: Eurostat (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Intensiteti i energjisë në prodhim

Intensiteti energjetik në Kosovë (sasia e energjisë së përdorur për të prodhuar një njësi 1000 Euro të BPV), është përmirësuar ndjeshëm me kalimin e kohës, deri sa në vitin 2020 janë shpenzuar 476 kgoe (kilogram për njësi ekuivalente të naftës) për 1000 euro të BPV, në vitin 2022 kemi rënie të intensitetit të energjisë, për vlerën e njëjtë të BPV janë shpenzuar 404 kgoe.

Figura 11: Intensiteti i energjisë




Burimi: Eurostat (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Emetimet e CO2

Emetimet e CO2 të Kosovës në sektorin e prodhimit për vitin 2022 janë, 0.657 Mt CO2 në vlerën e shtuar në prodhim(VSHP) 1137 milion euro, apo 0.58 kg CO2 për milion EUR në VSHP), nga viti 2015 në vitin 2022 ka rënie të emetimeve të CO2 për 26%, mirëpo është mbi mesataren e BP6. Vendet me emetim më të ulët në vitin 2022 janë Serbia me 0.37 kg CO2 /mil Euro dhe Bosna e Hercegovina me 0.48 kg CO2 për milion euro të VSHP-së. Shqipëria ka ulje të emetimeve të CO2 krahasuar me vitin paraprak, ende ka vlera të larta prej 0.89 kg CO2/ mil.euro. Poashtu edhe Mali i Zi emeton 0.80kg CO2/mil euro të VSHP-së.

Figura 12: Emetimet e CO2, për milion euro në Vlerën e Shtuar të Prodhimit




Burimi: International Energy Agency (IEA) (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Intensiteti i CO₂ për vlerën e shtuar në Prodhim

Intensiteti i CO₂ në konsumin e energjisë në Kosovë në vitin 2021 ishte 54.4 g/MJ, me një rritje për 10% nga viti 2015 që ishte 49.9 g / MJ. Mesatarja e vendeve të Ballkanit Perëndimor BP6 ishte 50 g/MJ. Intensitetin më të lartë të CO₂ në konsumin e energjisë e ka Shqipëria 64.5g/MJ për CO₂, ndërsa intensitetin më të ulët të CO₂ në konsumin e energjisë e ka Serbia me 31.4 g/MJ për CO₂.


Figura 13: Intensiteti i CO₂ në konsumin e energjisë për industrinë prodhuese



Burimi: International Energy Agency (IEA) (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

EKONOMIA E GJELBËR DHE QARKORE

Figura 14: Mbeturinat e trajtuara sipas llojit



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga stafi i DI/DPI-s)

Sasia e mbetjeve të trajtuara ndër vite: 2020 ishte 3,882 ton, në vitin 2021 ishte 23,328 ton, në vitin 2022 ishte 24,904 ton dhe në vitin 2023 ishte 25,736 ton.

Sasia e mbeturinave të trajtuara sipas llojit, e shprehur në përqindje për vitin 2023 ishte:

Mbeturinat nga letra dhe kartoni (65,5%);

Mbeturinat nga plastika (16,4%);

Mbeturinat nga metalet (18,1%).

Nga të dhënat e mësipërme shohim se kemi një rënie të theksuar në trajtimin e mbeturinave të plastikës, nga 37.2 % sa ishte në vitin 2022 në 18.1% në vitin 2023 dhe një ngritje të theksuar në trajtimin e mbeturinave të letrës dhe kartonit nga 47.4% sa ishte në vitin 2022 në 65.5% në vitin 2023.

Përmbledhje e indikatorëve

- Kosova paraqet performancë më të ulët ekonomike të përgjithshme në BPV / kokë banori prej 6,747.40 € për vitin 2024, që do të thotë se është nën mesataren e BP6 sa është 10,159.20 €;
- Industria përpunuese (Sektori C) në BPV merr pjesë me 13.1%;
- Në vitin 2024, industrializimi i Kosovës, i matur me pjesëmarrjen e VShP në BPV, është (13.1%) më e lartë se mesatarja e Vendeve të BP6 (10.1%);
- IHD-të hyrëse në sektorin e prodhimit, në vitin 2024 ishin 32 milion euro;
- Pjesëmarrja IHD-ve të prodhimit në totalin e IHD-ve për vitin 2024 është 3.78%;
- Norma efektive e interesit në sektorin e industrisë përpunuese për vitin 2024 është 6.4%;
- Rreth 60% e eksportit realizohet në 6 shtete: Shqipëri, Gjermani, Maqedoni e Veriut, Zvicër, SHBA dhe Serbi;
- Rreth 60% e importit, realizohet nga 7 shtete: Gjermani, Turqi, Kinë, Itali, Greqi, Maqedoni të Veriut, Shqipëri;
- Sektori C- Industria përpunuese, në normën e punësimit sipas aktivitetit ekonomik merr pjesë me 10.74%;
- Pjesëmarrja e punësimit të grave në prodhim është 21%;
- Paga mesatare në sektorin C për vitin 2024 është Bruto 528.00 € dhe Neto 451.00 €;
- Emetimet e CO₂, të Kosovës në sektorin e prodhimit për vitin 2022 janë, 0.657 Mt (mil/ton) CO₂;
- Në vitin 2023 sasia e mbetjeve të trajtuara (ricikluara) ishte 25,736 ton, në përqindje sipas nënsektorëve: Letra dhe kartoni (65,5%); Plastika (16,4%) dhe Metalet (18,1%).

Konkluzionet

- Kosova edhe pse ka treguar rritje të BPV-së për kokë banori dhe është rritur me një rritje më të shpejt se vendet e rajonit, ende është nën mesataren e vendeve të BP6;
- Industrializimi i Kosovës, i matur me pjesëmarrjen e VSHP-së në BPV, tregon një qëndrueshmëri ndër vite dhe është më i lartë se Mali i Zi, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina;
- Struktura e përbërjes ekonomike të Kosovës, bazuar në pjesëmarrjen e VShP-së në BPV, vazhdon të dominohet nga sektori i shërbimeve, me një mesatare prej 46%, ndërsa sektori i prodhimit merr pjesë me një mesatare prej 13% të VSHP në BPV;
- Investimet e Huaja Direkte janë një nga faktorët që ndikojnë në rritjen ekonomike. Në Kosovë IHD-të janë ende të orientuara në sektorin e patundshmërive dhe financiare dhe të sigurimit, e që kanë më pak efekt të përhapjes/shtrirjes në ekonomi (spillover effect);
- Normat e interesit bankar janë ende të larta për industrinë përpunuese me 6.4%, gjë që u pamundësojnë bizneseve zgjerimin e kapaciteteve të tyre në prodhim;
- Industria prodhuese/përpunuese ka potencial të lartë në uljen e deficitit tregtar, duke marr parasysh pjesëmarrjen në eksportin e përgjithshëm me 78.5%, ku mbulueshmëria e importit me eksport është me vetëm 14.8%;
- Eksportet e produkteve të industrisë prodhuese/përpunuese janë nga vendet ku është e përqendruar diaspora, gjë që e pasqyron diversifikimin e kufizuar të eksporteve në tregun e përgjithshëm;
- Importet e industrisë përpunuese vazhdojnë të jenë të larta, për arsye se ekonomia e Kosovës nuk po arrin të intensifikoj sigurimin e lëndëve të para nga burimet vendore që do të kontribuonin në uljen e importit;
- Sektori i industrisë përpunuese ka potencial për punësim më të lartë të grave, por pjesëmarrja e grave në punësim te ky sektor vazhdon të jetë e ulët, në krahasim me vendet e BP6;
- Vlerësuar produktivitetin dhe pagat, Kosova dhe vendet tjera të BP6, kanë shënuar rritje në paga. Megjithatë, Kosova ka shënuar rritje në normën e produktivitetit dhe rezulton ende në intensitetin më të ulët të pagave në raport me vendet e rajonit;
- Eficienca e energjisë në industrinë prodhuese/përpunuese në Kosovë vazhdon të ketë rritje ndër vite dhe qëndron nën mesataren e vendeve të BP6, më mirë se Shqipëria dhe Mali i Zi;
- Emetimet e CO2 në industrinë prodhuese/përpunuese në Kosovë vazhdojnë të kenë rënie ndër vite, mirëpo qëndron mbi mesataren e vendeve të BP6 dhe ka më pak emetim të CO2 se Shqipëria dhe Mali i Zi.

- Qasja e Kosovës në përmbushjen e rregullave të përgjithshme për mbrojtje të mjedisit, ka filluar me iniciativën që të zhvillojë industrinë qarkore me qëllim të reduktojë mbetjet.

Referencat

- Agjencia e Statistikave të Kosovës / Anketa e Fuqisë Punëtore
- Agjencia e Statistikave të Kosovës, Vjetari Statistikor
- Banka Qendrore e Kosovës, Raporti vjetor 2023
- Banka Qendrore e Kosovës, IHD sektoreve ekonomik, <https://bqk-kos.org/statistikat/serite-kohore>
- Banka Qendrore e Kosovës, IHD sipas vendeve, <https://bqk-kos.org/statistikat/serite-kohore/> qasur më 10.07.2024
- Exports by enterprise size class - OECD iLibrary, https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/entrepreneur_aag-2013-11-en.pdf
- International Energy Agency (IEA)
- United Nations Industrial Development Organization (UNIDO), <https://www.unido.org/search?keys=wages+kosovo>
- World Development Indicators (WDI), <https://databank.worldbank.org/source/world-development-indicators>
- World Integrated Trade Solution (WITS), <https://wits.worldbank.org/>
- Eurostat, https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?oldid=565248&utm_source=chatgpt.com / qasur më 11.09.2025

Ky raport është përgatitur nga Departamenti i Industrisë/Divizioni për Politika Industriale.

Kontakti:

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Departamenti i Industrisë, Divizioni për Politika Industriale

Rruga "Arbënor e Astrit Dehari" nr. 21, Lagja e Spitalit

10000 Prishtinë/Republika e Kosovës

Tel: +383 38 200 36 545; 36 547

<https://mint.rks-gov.net/>